



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1017/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin Mergime Berisha, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1017/2021, paraqitur nga Mergime Berisha, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin kanë kërkuar rinumërimin e votave.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga Mergime Berisha, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje me të cilën pretendon se në vendvotimet që kanë shkuar në rinumërim në Komunën e Vushtrrisë për tjetërsim vote është edhe vet apeluesi andaj shpreh pakënaqësinë për shkelje nga anëtarët e Këshillit të Vendvotimit në vendvotimet VV 2701B/02R, VV 2701B/08R, VV 2702B/05R, VV 2728B/01D, VV 2702X/01R, VV 2704B/04R, VV 2704B/14D, VV 2730B/02D, VV 2712B/01R, VV 2713B/01R, VV 2717B/02R. Ndërsa në vendvotimet 2709B/02R, 2711B/01R, 2711B/01R, 2711B/02D, 2714B/01R, 2714B/02R, 2714B/03R, 2714B/04D, 2717B/01R, 2717B/02R, 2717B/03D, 2721B/01R, 2721B/02D, 2727B/01R, 2727B/02D, 2731B/01R, 2731B/0D2, 2702B/01R, 2702B/03R, 2702B/04R, 2701B/01R, 2702X/03R, 2702X/05D, 2704B/12R, 2704B/14R, 2704B/07R, 2706B/02R, 2703B/01R, 2713B/02R, 2713B/01R, 2721B/02D dhe 2708B/01R në të cilat mendon se ka manipulim të votave dhe është tjetërsuar vullneti i qytetarëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Mergime Berisha, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Vendvotimet 2709B/02R, 2711B/01R, 2711B/01R, 2711B/02D, 2714B/01R, 2714B/02R, 2714B/03R, 2714B/04D, 2717B/01R, 2717B/02R, 2717B/03D, 2721B/01R, 2721B/02D, 2727B/01R, 2727B/02D, 2731B/01R, 2731B/0D2, 2702B/01R, 2702B/03R, 2702B/04R, 2701B/01R, 2702X/03R, 2702X/05D, 2704B/12R, 2704B/14R, 2704B/07R, 2706B/02R, 2703B/01R, 2713B/02R, 2713B/01R, 2721B/02D dhe 2708B/01R, në Komunën e Vushtrrisë është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesit e apelit në mbështetje të pretendimeve të tyre, nuk kane ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e tyre nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara andaj këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Keshtu që Paneli vlerësoi se apeli nuk është i bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.1017/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.